

Abstrakt

Ky punim synon të vlerësojë çeshtjet kryesore që dalin nga banka dhe sistemi bankar i vendeve të caktuara, me këtë studim po ashtu kuptojmë se sa rëndesi kanë bankat në jetën ekonomike të një vendi.

Për të kuptuar me mirë dhe me drejtë bankat si një ndër institucionet më të rëndësishme ekonomike, më është dashur që të paraqes edhe zhvillimin, funksionet, karakteristikat e bankave të shtetëve të ndryshme duke u bazuar në sistemet e tyre bankare dhe duke përfshirë edhe bankat si: banka qendrore, bankat komerciale në vendet e ndryshme, bankat afariste, bankat universal, investive, etj...

Më anë të këtij punim jam munduar të arrijë që të kuptohet rëndësia e madhe e bankës që ka për secilin sistem bankar në vendet e zhvilluara, shërbimet që ato i kanë ofruar gjatë historisë dhe shërbimet që ato i ofrojnë në ditët e sotme.